

EQEREM CANAJ  
**LIRIA**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



EQEREM CANAJ

LIRIA

*roman*

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928376589

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al/>

*I ndrituri, Dritëro Agolli!*

*Kah viteve shtatëdhjetë, kur unë bëja pelegrinin e romanit të parë “Njeriu me nofulla të hekurta”, ju marrisht, premtuat se do të ktheheshit, sërish, në fshatin tim e do të sajdisnim romanin madhor “Liria” ... Se do të pinim gjithë ditën e do të shkruanim gjithë natën apo, si ta sillte rasti...*

*Unë ju prita gjatë. Po juve nuk jua bëri për mbarë shansi. Tashmë, munda, vetë më vete, t’jua freskoj kujtesën, duke ju dhuruar juve një dorë letërsi. Pse, domosdoshmërisht, e ndien këtë, shprehja e shpirtit poetik që, herët a vonë, ora të mos ngecë: në ajri të lexohen premtimet, ngjyrat.*

*Fort miqësisht, pranojeni dedikatin tim të poemit “Liria” për ju.*

***Autori***



NË OAZËN VETËROMANORE TË MIRËFILLTË  
(*Si shkas për leximin e romanit “Liria”.*)

*Prof. dr. Fatmir Terziu*

## Hyrje

Shkrimtari vlonjat, Eqerem Canaj, vjen përpara lexuesit me romanin e tij “Liria”. Në këtë roman, me një narrative të rëndësishme dhe të përkushtuar, Canaj, një nga krijuesit tanë jugorë të letërsisë, paraqet një memorie të fortë narrative dhe një dedikim të ndjeshëm, që merr shkas në vitet shtatëdhjetë, por dedikimin e ka me emër të qartë e të saktë, një përkushtim kohor për të madhin Dritëro Agolli. Duke u mbështetur në tematikën dhe rrjedhën e jetës, nga Pari i Parikut, traditës labe, emrit të njeriut të dëgjuar për trimëri e cilësi të rralla, që përsëritej nëpër breza, e mjaft gjëra të tjera të ngjashme, autori Eqerem Canaj shqyrton lidhjen e kohës me formën narrative dhe me një dimension etik të rrëfenjës letrare.

## **Anatemat ndryshuese dhe jetike**

Canaj me këtë roman, jo vetëm që na përshkruan udhë të ndjeshme, udhën narrative, por pohon se mënyra si ne mendojmë për botën dhe si i tregojmë ngjarjet shpesh në kundërshtim me natyrën e vërtetë, plot me ngjarje dhe të hapur të jetës së përditshme. Sipas narrativës së tij lexuesi ndien dhe mëson se rastësia dhe mundësia e të ardhmeve të ndryshme mund të ishin të gjitha iluzore.

Si rezultat, njerëzit nxjerrin përfundime ose pranojnë ideologji pa i shqyrtuar mjaftueshëm pasojat apo alternativat e tyre. Megjithatë, romani shkon tek anatemat jetike nëpër labirinte tregimtare për të na treguar se ka një mënyrë tjetër për të lexuar dhe për të ndërtuar fate dhe karaktere, artefakte letrare, art dhe estetikë nëpërmjet gjuhës, njohurisë, traditës, si edhe lidhjeve të tjera në këtë kontekst.

Një shembull i tillë i narrativës së këtij romani është kur autori nuk përmend bagëtitë, por thekson “Duhej të qe fundmuaji, kur të leshtat e kërkonin mizin, posa dielli mbulonte vendin”. Pra, të leshtat në këtë kontekst nuk janë gjë tjetër veçse një zëvendësim, një trajtesë, një formë e duhur ndryshe për të paracaktuar më shumë estetikë, më shumë lidhje të qëndrueshme e të ndjeshme diskurse të narrativës. Fundja krijimtaria është një afinitet në shtojcën gjuhë, dhe si e tillë vjen mjaft përshtat.

Me këtë rast ne shkojmë tek ajo që na shpjegohet mes narrativës se shumica e narrativave zhvillohen përmes parathënies karakterizuese e filluese dhe “mbrapshtijes” (parathënie e atribuar pas faktit), të cilat tentojnë të



reduktojnë shumëllojshmërinë e mundësive në çdo moment. Romani “Liria” i shkrimtarit vlonjat Eqerem Canaj, shkon kah nga vepra të tjera letrare, që përpiqen të përcjellin hapjen kohore përmes një pajisjeje që në letërsinë e sotme quhet “hije anësore”.

Hija anësore sugjeron që të kuptosh një ngjarje, do të thotë të kuptosh se çfarë tjetër mund të ketë ndodhur. Koha nuk është një vijë, por një grup i lëvizshëm i fushave të mundësive: “Tej, në fushën e bleruar, ndo dyqind metrash, moshatarët e tij, ndërsa kënaqeshin me lojërat popullore, me thirrmat e zhurmat, si shturje nervash, ngrinin botën në këmbë”. Në këtë mënyrë ne kuptojmë dhe argumentojmë se kjo pikëpamje, për kohën dhe narrativën e marrë në konsideratë, inkurajohet edhe terminologjia, komunikimi, didakti dhe jep më shumë informacion edhe për pluralizmin e mendimit, ndihmon për të na çliruar nga siguritë e rreme të dogmatizmit, krijon një skepticizëm të shëndetshëm ndaj ortodoksive aktuale, dhe na bën të vetëdijshëm se ka zgjedhje morale të disponueshme për ne.

Kjo shikohet më së miri në këtë paragraf: “Miku im, jeta e njeriut vërtet ka shumë të fshehta, por ajo zhvillohet natyrshëm. Unë kështu e kuptoj. Në të vërtetë jam me ty e pranë teje, po nuk e bëj dot vezën tënde. E di, gjithë Pariku të mban në gojë. Ti je i veçanti i familjes së Brahimajve. Por, bëhu pak më njerëzor. Kujto kryetrimin, pinjollin e fisit, kah je edhe trashëgimtar i emrit të famshëm të tij. Mendo e bëj më të mirën!”. Në këtë mënyrë shohim se karakteret dhe karakteristikat e tyre evoluojnë, sikurse ndodh në tregime që personazhet të ndryshojnë: “Një klithmë ofshaje

nga i biri kokëshkretë. Një rrotullamë, si gjarpër i vrarë, u rrëzua ai mbi kalldrëm. Nëna, me thikë gjakuar, bëri hapa në platformë. Rojat, që e diktuan në çast, sulen në lemeri”.

## **Rrethanat e ndryshimit dhe udhakthimi**

Ndryshimi nuk ndihet, nuk është as i vogël, por ndikohet nga shumë rrethana dhe fjalë të përzgjedhura që të mbetet masiv, sikurse janë “Me rrapëllimë e patërshanë”. Përveç shkallës së ndryshimit, ekziston një mënyrë tjetër e të menduarit për natyrën e harkut të personazhit tuaj kryesor: A përfundojnë ata më të lirë në fund sesa në fillim? Këtë e mëson nga leximi dhe nga rrjedhshmëria e ngjarjeve dhe e narrativës në këtë roman të shkruar me vëmendje e përkushtim.

Leximi të kalon syrin dhe veshin dhe, nëpërmjet të arsyetuarit në narrativë, pikëtakon “Parin e Ri”, si dhe “Hyqmet e Kapedan Guxhin” për të kuptuar thelbin e kësaj narrative pse “Lumi ecën së prapthi”, apo pse dhe “Trapi lidh dy brigje”.

“Porta e Trëndafilave” ka ngushticat e veta estetike, që shtrohen dhe hapen për të na dhënë metamorfozën, atë që pëson dhe i zoti i kasolles, e që habitshëm shkon më tej në mendimin e tij “Nuk paskam të bëj me një endacak”, sepse në fillim shtysa e tij vizive ndodh të ishte e gabuar në përshtkrim, në detaje dhe në atë që autori e sqaron në krye të herës.

Tek “Udhakthimi” autori është më didakt dhe që në fillim na jep të qartë mendimin. “Rrënimtari nisi rrugëtimin e endacakut, por në kahe të kundërta të udhëtimit të tij të gjatë, dmth., nëse kishte bredhirë përdrejt kah perëndonte dielli, tash e prapa orvate të kapte trivën, kah lindte dielli”.

Ndaj dhe “Udhakthimi” ka kuptim më vete. Ai, pra protagonist, që kishte kërkuar lirinë - paqen, në njëfarë mënyre, sipas mendjes, konceptit të tij, tashmë ndodhej në një dyzim mendimesh, por që në thelb kanë bekimin e vetë narrativës së bukur: “... e kam kërkuar lirinë - paqen, në njëfarë mënyre, sipas mendjes, konceptit tim dhe u kam mëshuar fort ideve të mia. Dhe kam bërë shumë mbroçkulla. Fjala vjen, në qytetin e karrierës sime kam lënë në të katër rrugët Kalindën me djalin tim, gjakun tim, Parin... Eh, jo se jam penduar, por dua të t’i them ca nga ndodhitë prej endacaku, që t’i mbash mend, pse ashtu ka ardhur puna ime, jeta ime. Dje, papritur e pakujtuar, kam takuar ballazi Bonjakun”.

“Udhakthimi” është filozofik. Është mjaft domethënës. Është një nyjë e artë në këtë narrativë dhe po aq në jetë. Aty ngulet vetë konteksti i lirisë, filozofia e saj. Diskursi dhe të tilla elemente artistike hyjnë thellë e më thellë për të kuptuar ndarjen dhe atë që kërkohet te “trapi që u hodh në bregun tjetër të lumit”.

Ajo që ndihet në këtë roman është silueta e njeriut që largohet, zvogëlimi dhe tretja në mjegull, sepse, ashtu sikurse mbyllet romani, vlen të mirëkuptohet se “liria gjendet kudo dhe askundi”.

## **Konkluzion**

Duke e përfunduar, sikurse e thamë që në fillim, romani kalëron mbi një ide dhe mbi një fakt kah vitet shtatëdhjetë, kur autori bënte pelegrinin e romanit të parë, e ku vetvetiu merrte bekimin e një pene si Dritëro Agolli, për të cilin ai gjen vend dhe përkushtim. Ky përkushtim dhe kjo narrative, jo vetëm si premtim, por edhe si një ndjenjë dedikuese, merr një formatim të ndjeshëm narrative dhe shkon në duart e lexuesit mjaft premtues.

Edhe pse një vepër e shkurtër, romani “Liria” i shkrimtarit Eqerem Canaj shkon në oazën e tij romanore të mirëfilltë.

*Londër, 30 nëntor - 1 dhjetor 2022*

## PJESA E PARË



## PARI I PARIKUT

Pari bënte emër në qytezën e Parikut. Edhe pse ai i përkiste një familjeje emërdëgjuar, qe veç një urtak, i cili bënte dritën e qiririt në errëtajën e gjithçkaje, ku s' bëhej fjalë për konceptin “dritë elektrike”, por diçka më përtej, ose më shumë se aq: dritërim mendimi, kjo, në raport me bashkëkohësit, si, fjala vjen, me babë e mëmë, punëtorë lavdi, ku, me djersë e mund të pamat, përballonin kohën dhe jetonin brenda gjinisë, si kushmuroftë, me Sherin, me Qametin, me Bonjakun, të cilët, pa plus-minus, përbënin grupmohën, njëri më i mirë a më i marrë se tjetri, çapkënë a hokatarë, dallkukë a kopukë, siç i paraqiste rasti a mosha, ku, për hir të fjalës, nuk ishin as fëmijë, as burra mbi të cilët të rëndonte barra e shtëpisë a pësia e fatit, çka burrat do t'i nënshtroheshin apo do ta çervetosnin atë me “shpatën e Damokleut”.

Lart, shumë lart, mu në barkun e qiellit, që qëndronte gjithherë gri, të dyja malet, Bozhuri e Hadi, që shënonin kufirin tokë-qiell, duke i përplasur kokat fort, si desh a dema të egër dimër-verë, nga gjaku boran dhe nga lloherat

tmerrane, formohej një përrua malor që duke çarë harca e shkëmbinj, përparonte tërbimshëm drejt perëndimit dhe e ndante krahinën malore në dy pjesë. Banorët e të dy krahëve, mund të quheshin, ndryshe, banorët e përroit të tërbuar, megjithëse po të tillët, këtë përrua lemeritës, e blinin dhe e shisnin edhe për lumë, edhe pse në hartë s'njihej për i tillë. Gjithaq, pranohej për e vërtetë se jeta e këtyre frymorëve që lidhur me jetën e këtij përroi malor, thujse në mënyrë të pazgjdhshme në: burimet kristalinë si ujë i pijshëm, në shfrytëzimin e forcës së ujit, në mullinjtë e blojeve të bereqetit, në përdorim për vaditje të tokave pjellore në të dy krahët e tij, për tezgjahët - ndërtimi i dërstilave e tabanëve në përpunimin e rrobave shajake, shirqe, guna, xhoke, llabane dhe vonë do të vinte radha edhe e ndërtimit të një hidrocentrali të vogël, i cili do të lidhej edhe me rrjetin elektrik kombëtar, shto edhe gjuetinë e troftës, e cila përbënte të veçantën e pamohueshme. Ky përrua formonte luginën e bukur e të egër, njëkohësisht, ku sa për bimësinë dhe njerëzit që, po ashtu, mbeteshin sa të këndshëm, bujarë, qistokë e fjalëmbël, por edhe kryeneçë e të papërmbajtur, kur lumi i halleve, dertëve, mëvetësia, pa diskutim, kapërcente caqet. Lumi nuk përfillte kufij. Kjo dukuri njerëzore nuk ishte një pamje drite e çastit të banorët, por, si patën treguar gjasat, ishte çështje gjeni.

Pariku qëndronte aty, që kurse ishte zënë dynjaja, thoshin, që gjithherë i mbytur në blerim të thellë, në të tëra stinët ndërmosh, madje, në dimrin egran blertaja e gjithkëndit merrte trajtë të errët në të zi dhe asisoj krijonte një shkretëti robine, mu në të majtë të llafazanit të kaltër, i



cili dimër-verë, dukej se i jepte frymë e shpirt qytezës me një grumbull shtëpish banimi. Ndoshta prej trysnisë së përroit, Pari me shokë, hera-herazi, ia baltonin atij, duke e cituar: “Qyteza e Kaltër”. Po, kjo anë, nuk kishte aspak rëndësi, pse krahët e punës, pra ata të aftit në moshë, merreshin me mbarështimin e gjësë së gjallë: dele, qengja, dhi e keca, lopë, dema, viça, qe parmende dhe gratë me përpunimin e bulmetrave e lëkurëve, me përpunimin e drithërave të bukës a përgatitjen e farës për mbjellje, të cilat, në pranverë, krah burrave e pendës së qeve, kur toka ishte gati për mbarsje, ato koqisnin farën, kokërr më kokërr, prapa parmendës së drurtë, sepse mbjellja kërkonte zanatçinj të zgjedhur; si bujkun dhe bujkeshën. Ndërsa, dimrit, gratë ushtroheshin si tezgjahiste, burrat, kryesisht, punë me bagëtinë, për t’i nxjerrë të forta prej dimrit. Kjo retorikë vazhdonte pa ndërprerje. Përveçse, në raste lufte. Atëherë, njëherësh, burrat linin bagëtinë në brinjë apo pendën e qeve në brazdë, vraponin për luftë, asosh, gratë bëheshin burra: do të zotëronin bagëtinë edhe bujqësinë, do të mbanin shtëpinë në këmbë, derisa burrat të ktheheshin nga lufta. Ishte kjo edhe një provë jete, ku klasifikoheshin fiset. Dhe Brahimajt, nga ky fakt, kishin mbetur derë me cifël.

Duhej të qe fundmuaji, kur të leshtat e kërkonin mrizin, posa dielli mbulonte vendin. Ndoshta që, atë ditë të djelltë, te rrepat e zallishtes, përbuzë përroit, të qenë mbledhur njëri pas tjetrit djemëria e qytezës. Ndofta edhe të rriturit i patën zbërthyer qetë e i patën lëshuar shelgut, që të mund t’i shfrytëzonin ca më mirë, sapo të fillonte fresku i pasdites. Ndërkohë, Pari pati zënë hijen e rrapit pranë burimit, kishte

rënë në të thella. Shumë gjasa jete, të cilat zhvilloheshin para syve të tij a të tjera e të tjera, që i mësonte prej rrëfimeve gojore për shëmbëlltyra, në kohë a vende të ndryshme, ndërsa i vinin, vrundull, brenda kafkës së kokës, bënte t'i vinte në një vijë, në linjë, teksa "pseja" që e godiste, herë pas here si çekan, në ato të fshehta të padukshme, bënte çoroditjen e çastit dhe shumë e mundonte për të bërë mendimzgjidhjen, çka më tej do të bënte çlirinë e do të niste të qeshte, sikur lironte kristalinën e ujit, që buronte nën ato rrënjë të vjetra të rrapit, të cilat bënë dukjen e të notuarit përmbi pusin e burimeve.

Tej, në fushën e bleruar, ndo dyqind metrash, moshatarët e tij, ndërsa kënaqeshin me lojërat popullore, me thirrmat e zhurmat, si shthurje nervash, ngrinin botën në këmbë. Sheri, ai djalë trupçelik, më besniku i moshës dhe i karakterit: serioz, i vëmendshëm, dëgjues i heshtur e reagues i matur, iu afrua dhe e pyeti për rrugëtimin e mendimeve të çala. Ngau:

"Vëlla, ti diçka ke, përse je hequr mënjanë?"

"Natyrisht, që kam diçka", foli tjetri mendimhumbur, me sytë përposhtë këmbëve, sikur, diku vërtet i pati humbur gjësendi e të mund ta gjente. Kjo gjë ia shtyti më tepër kureshtjen Sherit, andaj ia ngriti kokën dhe e detyroi tjetrin të vështroheshin dukshëm. Dhe sytë e mëdhenj, tejet të menduar, iu dukën si puse të thella, që fshihnin brenda shumëçka, andaj e çyste sërish:

"Ne jemi tanët, shumë gjëra i kemi të përbashkëta, të fshehtat e njërit a tjetrit nuk bëjnë punë për mirë, Pari".

Sheri shprehte pakënaqësinë e momentit. E, atë çast, tjetri iu kthye një realiteti të ri:

“Ky rrap, mbretëria jonë, kështu, siç është, nuk ndodhet i tillë në brendësi. Jam i bindur se, brenda trugut, ka gropa të zeza të errëta, vetëtimat e rrufeve dimërore, duke e goditur, nuk e kanë rrëzuar dot përdhe, po gropa të zeza kanë shënuar në trung. E përbrenda tyre mund të shumëzohen gjëzeza të këqija. Kjo nuk do mend shumë apo jo?”, sytë e Parit, nën vetullat e zeza, paksa çapraz, qenë bërë çurg, thuajse zhbiruar.

“Dhe kjo e mundon vëllanë tim?”, Sheri bëri kakarisjen e së qeshurës.

“Jo, aspak! - kundërshtoi tjetri me revoltë. - Unë të tilla gropa i shoh brenda kokës sime, sate, Qametit, Bonjakut, te prindërit e mi, të tutë, Qytezës së Parikut, a nuk thua?!”, dhe revanshi i mendimit bënte trandë.

Sheri ra nga degat, ai ia njihte shpirtin e qelibarit dhe ia kuptonte idetë:

“Dhe këtë botë do ta ndryshosh ti, unë, tjetri?”.

“Jo, vëlla, por së paku, të ndriçoj mendjen time. Pse, të kuptohemi mirë, brenda kafkës sime ekziston mendimi, por të menduarit është procesi më i ndërlikuar... Mendimi sulet si shigjetë, por, midis kësaj fushe, vetëtimthi shfaqet ‘uni’. Dhe ky është i pashmangshëm, sa më i vogël e më inaktiv të jetë ky ‘uni’, aq më i mirë shfaqet njeriu në jetë”.

“Miku im, jeta e njeriut vërtet ka shumë të fshehta, por ajo zhvillohet natyrshëm. Unë kështu e kuptoj. Në të vërtetë jam me ty e pranë teje, po nuk e bëj dot vezën tënde. E di, gjithë Pariku të mban në gojë. Ti je i veçanti i familjes së

Brahimajve. Por, bëhu pak më njerëzor. Kujto kryetrimin, pinjollin e fisit, kah je edhe trashëgimtar i emrit të famshëm të tij. Mendo e bëj më të mirën!”.

Pari, qysh prej çastit, i hodhi sytë larg, përtej tre brezave: Kryetrimi...

Aty në qytezën e Parikut, qëndronte ende më këmbë shtëpia e gjeneralit që, njëherë e një kohë, bënte zë në oborrin e pashait të Epirit. Në këto troje vetonin togu gjinor dhe argatët, që sajdisnin ekonominë, e cila, si gjithkund, qe një përzierje e gjithkahshme: tokë-buke, blegtori dhe pyje-kullotë. Por, dreqi ta hajë, ata ishin në gjen kryelartë e nervozë, që, për hiçgjë, merrnin flakë e ta bënin gjëmën sa hap-mbyll sytë. E për këtë, nga të pabindurit që bënin dalldi, pashai, aty në log të fshatit, ngujoi një ekspeditë qetore. I detyruar, për këtë ndërmarrje, pasi vendorët, kohë më kohë, i sillnin boll telashe pashallëkut në: mospagesën e taksave, rekrutimin e djemve në moshë dhe, veçanërisht, kur binte radha e rrëmbimit të bukurosheve për haremin e tij.

Dhe shkëndija nderi, në një ditë të tillë gushti. Jo vetëm ditën, por edhe natën guri digjej në hënë. Fshatarët rrethuan kazermat e ekspeditës, por, të paarmatosur, u kthyen ndër konakë të leqendisur e, po aq të revoltuar. E keqja, edhe pse aty komandonte një trimosh vendali. Qe veç një gjarpër helmati.

Po sherri mori dhenë. Komandanti i ekspeditës i xhindosur, urdhëroi arrestime ndajnate. Dhe krerët organizatorë, nja trembëdhjetë burra a përmbi, i lidhën e u bëjnë pre e torturave. Po kështu edhe atyre të ekspeditës